



SI MUND TA SHFRYTËZOJË KOSOVA MOMENTIN GJEOPOLITIK PËR T'U AFRUAR ME NATO-n?




Anëtarësimi në NATO shihet si nevojë urgjente e sigurisë për Kosovën, në një kontekst të rrezikut në rritje nga Rusia dhe tensioneve me Serbinë, por mbetet i kushtëzuar nga zhvillimet gjeopolitike. Kosova ka avancuar në bashkëpunimin me NATO-n përmes rritjes së buxhetit të mbrojtjes, pjesëmarrjes në ushtrime si Defender Europe dhe avancimit në Asambleenë Parlamentare të NATO-s. Ekspertët sugjerojnë integrim gradual dhe ofertë strategjike ndaj aleatëve, veçanërisht ShBA-së

BESIM KELMENDI
LIROHET NGA
DETYRA, AGRON
QALAJ USHTRUES
DETYRE I
KRYEPROKURORIT F. 4



NË VITIN
E DYTË TË
LIBERALIZIMIT
TË VIZAVE, BIEN
KËRKESAT PËR
AZIL NË BE F. 3



AKTUALE



IKD-ja: 28 KANDIDATË PËR
DEPUTETË TË PËRFSHIRË NË
RASTE PENALE F. 5

KQZ-JA AKREDITON MBI 18 MIJË
VËZHgues PËR ZGJEDHJET E 28
DHJETORIT F. 6

BEDRI HAMZA: SI KRYEMINISTËR
DO TË PUNOJ QË KOSOVA TË
BËHET SHTET I DIJES, ME EKONOMI
DIGJITALE TË ZHVILLUAR F. 6

EKONOMI



KONSUMI I RRYMËS TEJKAJON
REKORDET E MËPARSHME, BËHET
THIRRJE PËR KURSIM F. 8

MURATI: ATK-JA PËR HERË TË
PARË ARRIN SHIFRËN PREJ NJË
MILIARD EUROSH TATIME TË
MBLEDHURA BRENDA VITIT F. 8

SPORT



ARB MANAJ, "FUTBOLLIST I VITIT
2025", AMIR RRAHMANI, FITUES I
ÇMIMIT "FADIL VOKRRI" F. 11

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji
BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

SI MUND TA SHFRYTËZOJË KOSOVA MOMENTIN GJEOPOLITIK PËR T’U AFRUAR ME NATO-n?

Anëtarësimi në NATO shihet si nevojë urgjente e sigurisë për Kosovën, në një kontekst të rrezikut në rritje nga Rusia dhe tensioneve me Serbinë, por mbetet i kushtëzuar nga zhvillimet gjeopolitike. Kosova ka avancuar në bashkëpunimin me NATO-n përmes rritjes së buxhetit të mbrojtjes, pjesëmarrjes në ushtrime si Defender Europe dhe avancimit në Asamblenë Parlamentare të NATO-s. Ekspertët sugjerojnë integrim gradual dhe ofertë strategjike ndaj aleatëve, veçanërisht ShBA-së

PRISHTINË, 22 DHJETOR - Anëtarësimi në NATO është më shumë se një dëshirë politike për Kosovën - është nevojë urgjente. Ky është pozicioni që mbajnë jo vetëm autoritetet e vendit, por edhe disa aleatë të rëndësishëm, në kohën kur paralajmërimet për rrezikun në rritje nga Rusia nuk ndalen. NATO-ja premton se angazhimi i saj për stabilitetin e rajonit do të mbetet i palëkundur, por a mjafton kjo për një vend që ndodhet në vijën e parë të sfidave strategjike? Qeveria në detyrë e Kosovës konfirmon se anëtarësimi në aleancën ushtarake të Perëndimit mbetet synim i Republikës, por thekson se ruga drejt këtij objekti “varet edhe nga rrethanat dhe zhvillimet gjeopolitike”. Zyrtarët nuk i dhanë një përgjigje të drejtpërdrejtë Radios Evropa e Lirë nëse ka plane për një aplikim formal për anëtarësim, por vunë në pah angazhimin e vazhdueshëm të vendit në këtë drejtim. “Gjatë viteve të fundit i kemi rritur ndjeshëm investimet e dedikuara për mbrojtje. Në vitin 2024, Republika e Kosovës, përkatësisht Kuvendi i Kosovës, e ka avancuar statusin e tij në Asamblenë Parlamentare të NATO-s nga anëtar vëzhgues në anëtar të asociuar. Ndërkaq, tri herë, më 2021, 2023 dhe 2025, kemi qenë vend pjesëmarrës dhe mikpritës i ushtrimeve ushtarake Defender Europe”, tha zëdhënësi Përparim Kryeziu për Radion Evropa e Lirë. Nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, Shqipëria, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut janë tashmë anëtare të NATO-s. Bosnje dhe Hercegovina dhe Serbia janë pjesë e Partneritetit për Paqe, ndërsa Kosova mbetet jashtë edhe këtij kuadri bashkëpunimi, për arsye politike. Në NATO-n 32-anëtarëshe janë katër vende - Greqia, Rumania, Sllovakia dhe Spanja - që nuk e njohin pavarësinë e Kosovës, ndërsa për shumicën e aleatëve, normalizimi i marrëdhënieve të saj me Serbinë mbetet kusht kyç për çdo hap përpara drejt anëtarësimit.

Serbia, nga perspektiva e Kosovës, përbën rrezikun kryesor të sigurisë, ndërsa Rusia shihet si aktori që e ushqen dhe e shfrytëzon këtë tension për të zgjeruar ndikimin e saj destabilizues në Ballkan. Ndaj, zgjerimi i NATO-s me Kosovën do të kontribuonte në forcimin e stabilitetit rajonal, sipas presidentes Vjosa Osmani. “Për ne, të jemi në NATO nënkupton të jemi të sigurt. Mendoj se Rusia ka interes afatgjatë për ta destabilizuar Ballkanin Perëndimor, e përmes tij gjithë kontinentin evropian. Dhe nuk do të heqë dorë nga ky synim”, tha Osmani në një intervistë për Politico-n. Shefi i NATO-s, Mark Rutte, ngriti alarmin më 11 dhjetor, duke paralajmëruar se aleatët e Aleancës janë shënjestra e radhës e Rusisë. “Rusia e ka rikthyer luftën në Evropë, dhe Evropa duhet të jetë e përgatitur”, sipas tij. Qysh prej nisjes së pushtimit të plotë rus të Ukrainës, para gati katër vjetësh, Kosova ka kërkuar disa herë anëtarësim të përhpejtuar në NATO. Radio Evropa e Lirë pyeti në këtë aleancë nëse ka plane për të thelluar angazhimin me Kosovën, përtej misionit paqeruajtës KFOR, apo nëse po shqyrtohen mekanizma që do t’i ofronin Kosovës garanci më të fuqishme sigurie. Në përgjigjen e marrë nga një zëdhënës thuhet vetëm se “Ballkani Perëndimor, në përgjithësi, mbetet lart në agjendën e NATO-s. Është një rajon me rëndësi strategjike për Aleancën. Angazhimi ynë për stabilitetin e tij është i palëkundur dhe ne nuk do të lejojmë që të ketë vakum të sigurisë”. Ndërsa pranoi se shtetet autoritare, si Rusia, përpiqen të ndërhyjnë dhe të minojnë demokracitë, zëdhënësi i NATO-s nënvizoi gjithashtu situatën e brishtë të sigurisë në Kosovë, duke e cilësuar dialogun me Serbinë si thelbësor për zgjidhjen e çështjeve të hapura. NATO-ja u zgjerua për herë të fundit vitin e kaluar me Suedinë. Pushtimi rus i Ukrainës e nxiti atë dhe Finlandën një vit më



herët t’u jepnin fund dekadave të neutralitetit ushtarak dhe të kërkonin siguri kolektive. Këtë javë, presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, njoftoi se vendi është i gatshëm të heqë dorë nga aspiratat për anëtarësim në NATO, në këmbim të garancive të sigurisë. Pavarësisht kësaj, anëtarësimi i Ukrainës në aleancë - anëtarët e së cilës janë të detyruara ta mbrojnë njëra-tjetrën - ka qenë gjithmonë thuajse i pamundur, për shkak të kundërshtimit të Rusisë. Ish-zyrtari i lartë i NATO-s, Jamie Shea, thotë se Kosova ndoshta mund të përfitojë nga kjo situatë, sepse NATO-ja nuk dëshiron të krijojë përshtypjen se Rusia ka të drejtë vetoje mbi vendimmarrjen e saj. “NATO-ja është krenuar gjithmonë me autonominë e vendimeve të saj. Dhe, nëse për momentin i duhet të heqë dorë nga anëtarësimi i Ukrainës, ajo mund të dëshirojë ta kompensojë këtë duke u zgjeruar drejt dy vendeve kandidatë në Ballkanin Perëndimor - Bosnje dhe Hercegovinës dhe Kosovës - për të treguar se dyert e Aleancës mbeten të hapura”, thotë Shea për programin Expose të Radios Evropa e Lirë. Neni 10 i Traktatit të NATO-s përcakton kushtet e zgjerimit, duke theksuar se anëtarësimi u ofrohet të gjitha shteteve evropiane që ndajnë vlerat e Aleancës dhe kanë kapacitetin të kontribuojnë në sigurinë e Atlantikut të Veriut. Ish-ministri i Mbrojtjes i Shqipërisë, Fatmir Mediu, i cili ka marrë pjesë në negociatat për anëtarësimin e vendit të tij në NATO, argumenton se Kosova ka përparuar në aspektin ushtarak, por vë në pah pengesat në funksionimin e brendshëm të shtetit. Për pjesën më të madhe të këtij viti, Kosova ka qenë me qeveri në detyrë dhe pa kuvend funksional. Mediu nënvizon rëndësinë e unitetit politik, duke përmendur edhe përvojën e Shqipërisë, ku

pushteti dhe opozita kanë pasur qëndrim të përbashkët gjatë procesit të anëtarësimit. “Pa këtë, është e pamundur të avancohet në NATO. NATO-ja nuk është vetëm një dëshirë. Është një proces i angazhimeve politike, institucionale, juridike, i luftës kundër krimit, kundër korrupsionit... Kjo është paketa politike. E, pastaj, vjen reforma në forca të armatosura, ku Kosova nuk ka ecur me hapa të ngadaltë, por me hapa pozitivë”, thotë Mediu për Exposeden. Sipas Mediu, integrimi i Kosovës në NATO nuk vjen vetëm duke u pozicionuar kundër Serbisë apo Rusisë - ai kërkon ofertë konkrete strategjike ndaj aleatëve, veçanërisht ShBA-së. Marrëdhëniet me ShBA-në, thotë ai, nuk mund të merren si të mirëqena; duhet të jetë e qartë se çfarë ofron Kosova dhe faktori shqiptar në rajon në këmbim. Ai sheh zgjidhje në integrim gradual de facto: bashkëpunim ushtarak rajonal dhe kapacitete të përbashkëta operative. “Kjo do të ishte një platformë shumë pozitive për ta përhpejtuar procesin. Nëse Kosova do të përfshihej me vendet tjera të NATO-s në rajonin e Ballkanit, në krijimin e niveleve të përbashkëta operacionale, që kanë të bëjnë me forca të gatshme për të vepruar, me vëzhgimin e hapësirës ajrore, detare, tokësore etj., Kosova, de facto, do të ishte e kyçur në një marrëdhënie me NATO-n”, thotë Mediu. Në të njëjtën linjë, Shea thotë se Kosova duhet ta thellojë bashkëpunimin me Shqipërinë dhe Kroacinë, me të cilat tashmë ka partneritet në fushën e mbrojtjes, për të demonstruar kontributin e saj në stabilitetin rajonal. Paralelisht, sipas tij, vendi duhet t’i avancojë reformat e brendshme dhe angazhimin diplomatik. “Mendoj se, së pari, duhet të kemi një marrëdhënie më të mirë pune mes Qeverisë së

Albin Kurtit dhe Shteteve të Bashkuara dhe fuqive kryesore evropiane. Të flasim hapur, këto marrëdhënie nuk kanë qenë të lehta gjatë viteve të fundit, dhe Kurti është përballuar me kritika të drejtpërdrejta nga ShBA-ja dhe disa aleatë evropianë. Gjendja e brendshme në Kosovë, me bllokadat në Parlament, dështimin për të zgjedhur kryetar, dhe fakti që tani kemi sërish zgjedhje më 28 dhjetor, ka ndikuar gjithashtu që jostabiliteti politik të mos shkojë në favor të Kosovës”, thotë Shea. Ai shton se anëtarësimi i Kosovës në NATO do të sillte kryesisht përfitime politike, pasi KFOR-i e mbron vendin me vite tashmë. Anëtarësimi do t’i siguronte njohje të plotë, vend në tryezën e NATO-s, kredibilitet ndërkombëtar dhe rol më të fuqishëm në sigurinë rajonale dhe evropiane. Megjithatë, Shea paralajmëron se çdo reduktim apo ripozicionim i forcave amerikane në Evropë do ta detyronte kontinentin të merrte më shumë përgjegjësi për mbrojtjen konvencionale, përfshirë edhe Kosovën. Këtë vjeshtë, ShBA-ja ka njoftuar për një reduktim të forcave rotative amerikane në Rumani. Radio Evropa e Lirë ka pyetur Departamentin amerikan të Mbrojtjes më 31 tetor dhe më 16 dhjetor nëse këto ndryshime do të kenë ndonjë ndikim në pozicionimin ushtarak të ShBA-së në Ballkanin Perëndimor, por nuk ka marrë përgjigje. Në fillim të këtij muaji, në Komitetin për Politikë të Jashtme të Dhomës së Përfaqësuesve të ShBA-së u diskutua për situatën në Ballkanin Perëndimor, ku përfaqësuesi republikan, Keith Self, e përshkroi rajonin si një “shkrepsë” dhe theksoi se udhëheqja e ShBA-së duhet të ketë një ndikim të rëndësishëm në ruajtjen e stabilitetit atje. “Vendet e NATO-s në Ballkan duhet të punojnë së bashku për të ndërtuar mbrojtje ushtarake dhe politike. Kosova është veçanërisht e ekspozuar pa anëtarësim në NATO - proces që mbetet i bllokuar për shkak të refuzimit të Spanjës, Greqisë, Rumanisë dhe Sllovakisë për ta njohur pavarësinë e saj”, tha Self. Edhe pse konteksti gjeopolitik ka ndryshuar ndjeshëm, vendet mosnjohëse nuk kanë lëvizur, por ngjashëm as Kosova nuk ka bërë ndonjë hap të madh, përveçse nga një cikël i rregullt zgjedhor në fillim të vitit në një tjetër të parakohshëm tani në fund. E nga këndvështrimi i sigurisë, ky ritëm mund të shihet si një shembull i kuptimit të vonuar të urgjencës strategjike.

NË VITIN E DYTË TË LIBERALIZIMIT TË VIZAVE, BIEN KËRKESAT PËR AZIL NË BE

Viti 2024 solli liberalizimin e shumëpritur të vizave për kosovarët drejt vendeve të zonës Schengen. Me numrin më të madh të turistëve, vendet e Bashkimit Evropian vërejtën edhe një numër më të madh të azilkërkuësve nga Kosova. Megjithatë, në vitin e dytë të udhëtimit pa viza drejt zonës Schengen, numri i azilkërkuësve nga Kosova ra dukshëm

PRISHTINË, 22 DHJETOR - Pa viza drejt 29 vendeve anëtare të zonës Schengen, kryesisht shtete anëtare të BE-së... Ky lajm kishte ardhur me paralajmërimin se liberalizimi i vizave mund ta përkeqësojë trendin e migrimit nga Kosova. Dhe, gjatë vitit të parë, më 2024, kishte ndodhur pikërisht kjo, sipas të dhënave të Zyrës së Statistikave të BE-së, Eurostat.

Trendi, megjithatë, ndryshoi në vitin e dytë të mundësisë së udhëtimit pa viza.

Edhe pse janari i këtij viti shënoi numrin më të lartë të kërkesave për azil nga qytetarët e Kosovës në vendet e Bashkimit Evropian për një fillimvit, trendi ra dukshëm në muajt pasues.

Në disa muaj ky numër ishte madje më i ulët se në vitet para liberalizimit të vizave.

Në parim liberalizimi i vizave


mundëson udhëtime pa viza vetëm deri në 90 ditë - brenda gjashtë muajsh - në cilindo nga 29 shtetet anëtare të zonës Schengen.

Udhëtimet pa viza duhet të shërbejnë kryesisht për vizita turistike, çështje familjare ose të ngjashme, dhe assesi për punë apo përfitime të tjera.

Në Kosovë kishte shqetësime se shumë të rinj mund ta shfrytëzojnë këtë mundësi për të tentuar të gjejnë punë apo për të kërkuar azil.

Edhe pse në të kaluarën kishte një numër dukshëm më të madh të burrave që kërkuar azil në BE, ky dallim pothuajse u zhduk në dy vjetët e fundit.

Ky është një lajm i mirë për kosovarët, pasi që trendi i aplikimeve më të mëdha për azil rrezikon edhe marrëveshjen për liberalizimin e vizave.



Bashkimi Evropian ka në dorë të ashtuquajturin Mekanizëm të pezullimit të vizave.

Me këtë mekanizëm, një vendi joanëtar të BE-së, si Kosova, mund t'i pezullohet përkohësisht

përfshirja nga vizat, nëse bën keqpërdorime, apo ka rritje të konsiderueshme të migrimit të parregullt.

Për më tepër, këtë muaj, Këshilli i Bashkimit Evropian e përfshiu

Kosovën në listën e vende të sigurta të origjinës, në përpjekje për ta përshpejtuar kthimin e migrantëve, duke e bërë më të vështirë për qytetarët nga këto vende të kërkojnë azil në BE.

BESIM KELMENDI LIROHET NGA DETYRA, AGRON QALAJ USHTRUES DETYRE I KRYEPROKURORIT

PRISHTINË, 22 DHJETOR - Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) ka aprovuar kërkesën e Besim Kelmendit për lirim nga pozita e ushtruesit të detyrës të kryeprokurorit të shtetit. Kërkesa e tij u miratua me gjashtë vota të anëtarëve në mbledhje të jashtëzakonshme të hënën.

Agim Qalaj u propozua dhe u caktua në pozitën e u. d. kryeprokurorit të shtetit. Kundër këtij propozoi votoi anëtar Dardan Vuniqi.

Besim Kelmendi i ka kërkuar Këshillit Prokurorial të Kosovës ta lirojë nga pozita e ushtruesit të detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, një javë pasi gjykata e lartë e anuloi shkarkimin e tij që kishte nxitur polemika e kritika.

Në një shkresë të dorëzuar në Këshillin Prokurorial, Kelmendi tha se kërkesa për t'u liruar nga detyra është "pasqyrim i vullnetit tim për ta mbështetur reformën në Sistemin Prokurorial dhe për të kontribuar në përmirësimin e gjendjes së krijuar në Këshill", raportoi "Betimi për Drejtësi" të hënën.

Kelmendi theksoi se dëshiron të largohet nga kjo detyrë - të cilën e ka mbajtur nga prilli i vitit 2022 - pas vendimeve gjyqësore për



rastin e tij dhe gjendjes së krijuar në Këshillin Prokurorial.

Kërkesa e tij vjen vetëm pesë ditë

pasi Gjykata Supreme e anuloi vendimin e Këshillit Prokurorial për shkarkimin e tij, duke e

quajtur të kundërligjshëm.

Kelmendi ishte shkarkuar muajin e kaluar pas raportimeve

se ai gjoja kishte bashkëpunuar më 1999 me një gjyqtare serbe për rastin e Masakrës së Reçakut, të cilën ajo e konsideronte ngjarje të trilluar. Ai i ka mohuar këto pretendime. Shkarkimi i tij nxiti reagime nga bashkësia ndërkombëtare dhe shkaktoi polemika për ligjshmërinë e vendimit, pasi ai u votua nga vetëm pesë anëtarë të Këshillit Prokurorial. Pjesa tjetër e anëtarëve vlerësuan se s'kishte kuorum dhe e quajti vendimin "puç institucional". Kelmendi u ankua në Supreme pasi Gjykata Themelore nuk ia pranoi ankesën kundër shkarkimit. Supremja gjeti se vendimi i Këshillit Prokurorial ishte "i kundërligjshëm, arbitrar dhe i pabazë".

Në shkresë, Kelmendi tha se dëshiron ta vazhdojë karrierën si prokuror dhe u zotua se do të punojë "me përkushtim për të mirën e sistemit prokurorial". "Dhe krejt në fund, unë, si prokuror në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, do të punoj më përkushtimin tim më të madh për të mirën e Sistemit Prokurorial, i pavarur, i paanshëm dhe me profesionalizëm, ashtu siç më ka vlerësuar Këshilli Prokurorial", përfundoi ai.



A NDRYSHUAN QËNDRIMET E LV-së SË VONI? NËSE PO, PSE?

Kur kanë mbetur edhe pak ditë para zgjedhjeve të 28 dhjetorit në Kosovë, Lëvizja Vetëvendosje duket se e ka ndryshuar diskursin. Për vëzhguesit, ndryshimet në qëndrime janë më shumë strategji e partisë në pushtet për ta përmirësuar imazhin. Ata paralajmërojnë se LV-ja mund t'i kthehet "gjuhës polarizuese"

PRISHTINË, 22 DHJETOR - Nga bojkotimi i medieve të Kosovës e sulmet ndaj gazetarëve, në prani më të madhe në to. Nga përdorimi i termave "hajvanë" e "hajvanat", me premtimin për një gjuhë më të matur dhe bashkëpunuese me partitë e tjera të mëdha shqiptare. Këto janë vetëm disa ndryshime në qëndrime që u vunë re gjatë paraqitjeve të fundit në medie të eksponentëve kryesorë të partisë në pushtet, Lëvizjes Vetëvendosje (LV), përfshirë edhe kreun e saj, Albin Kurti. Periudha kur janë bërë këto deklarata në studiot televizive është me rëndësi: kanë mbetur edhe pak ditë para zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit. Njohësit e zhvillimeve politike,

në parim, nuk e shohin ndryshimin si diçka të keqe, por në rastin konkret besojnë se moderimi i diskursit është strategji e LV-së për ta përmirësuar imazhin dhe është pjesë e kalkulimeve politike.

Roli i "palës së mirë"

Për Donika Eminin, hulumtuese në Grupin Këshillëdhënës në Evropë për Politikë të Ballkanit (BiEPAG), ndryshimi i fjalorit nuk është i rastësishëm. Sipas saj, intervistat e fundit të Kurtit, Glauk Konjufcës dhe Albulena Haxhiut në mediat lokale të Kosovës, "duken qartazi të orkestruara për të përgatitur terrenin" pas zgjedhjeve. "Së pari, kjo është një përpjekje për

ta vënë opozitën në diskomfort, duke luajtur rolin e 'palës së mirë', pas një viti të tërë të përdorimit të gjuhës toksike". "Së dyti, ky ndryshim lidhet drejtpërdrejt me nevojën për koalicionë. LV-ja është e vetëdijshme se nuk mund të qeverisë më e vetme si në vitin 2021. Prandaj, një gjuhë më e butë dhe një paraqitje si parti 'e pjekur' politike shërben për të hapur rrugën për bashkëpunime paszgjedhore", vlerëson Emini.

Edhe sociologu Artan Muhaxhiri është në të njëjtën linjë: ndryshimi i qasjes është pjesë e strategjisë. "Por, nuk besoj që partitë e tjera politike PDK, LDK, AAK, i besojnë këtij ndryshimi të befasishtëm dhe shumë të shpejtë të stilit politik të LV-së, pasi kanë pasur përvoja në të kaluarën se ky ndryshim është i përkohshëm dhe jo i përhershëm", thotë ai për Radion Evropë e Lirë. Muhaxhiri mendon se caku i LV-së tani janë votuesit e pavendosur dhe ata që kanë dilema nëse do ta votojnë ose jo këtë parti, që në zgjedhjet e 9 shkurtit të këtij viti mori 42 për qind të votave - shifër e pamjaftueshme për të qeverisur vetë.

Ai vlerëson se partia e Kurtit, që është në pushtet që nga zgjedhjet e vitit 2021, "nuk ka ndonjë argument të fuqishëm nga qeverisja e deritashme", prandaj, "aseti kryesor i LV-së në këto zgjedhje do të jetë ky ndryshimi retorik në mënyrë që, disi, edhe kësaj radhe të arrijë rezultat pozitiv, pasi përveç fjalëve, veprat i mungojnë".

"Koordinim me Listën Serbe", "njeri i Serbisë"...

Viti 2025 do të mbahet mend për polarizimet e skajshme mes partive politike shqiptare, qoftë në fushatën për zgjedhjet e shkurtit, më pas për pamundësinë e formimit të institucioneve, apo edhe gjatë garës në dy rundet e zgjedhjeve lokale. Gjithçka duket se nisi pasi Kurti e kuptoi rezultatin e zgjedhjeve të 9 shkurtit, doli para mbështetësve të tij dhe iu referua partive që ishin në opozitë në legjislaturën e kaluar si "hajvanë" dhe "hajvanat". Në një intervistë të dhënë së voni në televizionin lokal të Kosovës, Kanal10, kryeministri në detyrë Kurti, tha nuk e

mendoi të gjithë opozitën kur e përdori shprehjen "hajvanë" por vetëm një parti që, sipas tij, bëri premtime "iracionale dhe lajthitëse". "Por, ndoshta është dashur të gjej ndonjë fjalë tjetër", theksoi ai, duke mos treguar se kujt saktësisht i është referuar. Numri dy në LV, Glauk Konjufca, tha disa ditë më vonë në televizionin tjetër lokal, T7 se Kurti ka "reflektuar" dhe e ka pranuar se ka bërë gabim në këtë rast. Sipas Eminin, fyerjet si "hajvanë" i kanë shërbyer LV-së për t'i dobësuar kundërshtarët politikë dhe "për ta mobilizuar një elektorat të ushqyer me narrativ konfrontues". "Edhe pse kohët e fundit ka pasur një pranim të tërthortë se janë bërë gabime në raport me opozitën dhe mediat, kjo nuk e ndryshon faktin që kjo sjellje ka vazhduar praktikisht deri dy javë para zgjedhjeve". Për shkak të thellimit të ndasive, Lidhja Demokratike e Kosovës nuk pranoi të bashkëpunonte me partinë e Kurtit për një koalicion të mundshëm qeveritar, pavarësisht dy ftesave të LV-së. Edhe partitë e tjera shqiptare ishin kategorike kundër negociatave eventuale me Kurtin. Ani pse Kurti dhe

IKD-JA: 28 KANDIDATË PËR DEPUTETË TË PËRFSHIRË NË RASTE PENALE

PRISHTINË, 22 DHJETOR - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) tha se 28 kandidatë për deputetë për zgjedhjet e 28 dhjetorit janë të përfshirë në vepra penale dhe numri më i lartë i tyre vjen nga Lëvizja Vetëvendosje. Raporti i IKD-së, që analizoi listat e kandidatëve për deputetë, gjeti se nga 1 179 kandidatë, përveç 28 kandidatëve të përfshirë për vepra penale, janë edhe 19 kandidatë që kanë aktakuza aktive. Po ashtu, 12 kandidatë për deputetë në të kaluarën kanë qenë të dënuar me vendim të formës së prerë.

Në Listën e Lëvizjes Vetëvendosje, sipas IKD-së, janë 13 kandidatë që janë të përfshirë në raste penale, apo 11.81 për qind. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës ka gjashtë kandidatë që janë të përfshirë në raste penale, apo 5.45 për qind, pasuar me Nismën Socialdemokrate me tre kandidatë (2.72 për qind), Partinë Demokratike të Kosovës me dy kandidatë (1.81), sa ka edhe Lista Serbe (6.06 për qind), dhe me një kandidat të përfshirë në raste penale janë Lidhja Demokratike e Kosovës (0.9 për qind) dhe partia turke KDTP

(6.25 për qind). “Sa iu përket veprave penale në të cilat janë të përfshirë kandidatët, dominojnë veprat penale nga kapitulli i korrupsionit zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare dhe vepra penale ‘Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm’”, tha IKD-ja. Sipas Ligjit për Zgjedhje, një personi i kufizohet e drejta e garës për deputet vetëm nëse është i dënuar me vendim të formës së prerë me një vit e më shumë burgim në tre vjetët e fundit. “Përkundër kësaj, IKD, me qëllim të forcimit të

integritetit institucional të Kuvendit të Kosovës dhe integritetit personal të përfaqësuesve të popullit, në vazhdimësi ka lobuar që partitë politike t’i pastrojnë listat e deputetëve edhe nga persona të cilët kanë potencialisht probleme me ligjin në kuptim të dyshimeve për përfshirje në vepra penale, aktakuza, apo dënime të shqiptuara nga gjykatat, por që nuk hyjnë në kuadër të kufizimit ligjor”, tha IKD-ja. Për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit

janë certifikuar 24 subjekte politike. IKD-ja tha se duke iu referuar gjetjeve të hulumtimit lidhur me kandidatët që janë të përfshirë në vepra penale, del se, krahasuar me zgjedhjet e rregullta parlamentare të 9 shkurtit, është pësuar regres sa i përket numrit të kandidatëve për deputetë të cilët janë të përfshirë në raste penale, numrin e kandidatëve me dënime penale dhe numrin e subjekteve politike që në listat e tyre kanë përfshirë persona të përfshirë në raste penale.



Konjufca e kanë mohuar se gjuha e ashpër ka ndikuar në acarim raportesh, sa herë është përmendur Lista Serbe gjatë vitit, tensionet janë rritur. Lista Serbe është partia më e madhe e serbëve në Kosovë, e afërt me Beogradin zyrtar, me të cilën LV-ja nuk pranon asses bashkëpunim, por me raste pretendonte se partitë tjera shqiptare koordinoheshin me të. “Nëse më pyesni nëse PDK-ja është me Listën Serbe, jo nuk mendoj se është ashtu. A është LDK-ja me Listën Serbe? Jo, nuk mendoj”, tha Konjufca në intervistën e dhjetorit, duke shtuar se as LV-ja dhe as këto parti shqiptare nuk mendojnë për njëra-tjetrën se janë me Serbinë. Përgjatë vitit, akuza pati edhe nga këndi tjetër. Disa parti shqiptare nuk hezituan ta akuzojnë Kurtin se është “njeri i Serbisë dhe Rusisë”, pa ndonjë dëshmi.

Ndryshimi i radhës: Qasja ndaj ShBA-së

Kundërshtarët politikë jo rrallëherë e kanë përshkruar

Kurtin si “antiamerikan” dhe e kanë akuzuar për prishje të raporteve me aleaten kryesore të Kosovës, Shtetet e Bashkuara. Kurti është kritikuar edhe nga vetë ShBA-ja për veprimet në veriun e Kosovës të banuar me shumicë serbe, që janë cilësuar si të pakoordinuara. Më herët gjatë vitit, raportet mes Shteteve të Bashkuara dhe Kosovës pësuan një goditje tjetër me pezullimin e Dialogut të planifikuar Strategjik. Uashingtoni tha e mori këtë vendim duke u thirrur në shqetësime lidhur me veprimet e Qeverisë. Kurti fillimisht e pati pranuar se me administratën amerikane kishte dallime, por shtoi se “nuk jemi prishur me Amerikën”. Në intervistën e dhjetorit Kurti deklaroi se raportet me Uashingtonin ishin shumë të mira dhe që mospajtimet kryesore gjithmonë kanë qenë lidhur me Serbinë dhe strukturat e saj, dhe asnjëherë për çështje bilaterale. “Kurrë nuk kanë qenë, sa i përket mbrojtjes dhe sigurisë, marrëdhëniet më të mira sesa tani me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. E kemi kulmin. Si

shtet i pavarur e kemi kulmin sa i përket mbrojtjes dhe sigurisë”, u shpreh ai për Kanal10. Ky qëndrim i Kurtit, për Muhaxhirin është “në shpërputhje me realitetin”, pasi sipas tij, raportet mes dy shteteve “kurrë nuk kanë qenë më të dëmtuara”. Sipas tij, aspekti i sigurisë është një nivel tjetër nga ai politik dhe shpesh funksionon në mënyrë autonome. Hulumtuesja në BiEPAG, Donika Emini, vlerëson se në vitet e fundit, Kurti e ka përdorur antagonizmin ndaj ShBA-së dhe Bashkimit Evropian për “përfitime elektorale dhe politike”. “Tani, ndryshimi i narrativit për t’iu referuar Serbisë si shkak për mospajtimet tregon një përpjekje për të butësuar tonin ndaj aleatëve ndërkombëtarë dhe për të krijuar hapësirë për një qasje më konstruktive ndaj administratës së re amerikane”, vlerëson ajo. Një zëdhënës i Ambasadës së Shteteve të Bashkuara i tha Radios Evropa e Lirë më 17 dhjetor se SHBA-ja synon të punojë ngushtë me ekzekutivin e ri që do të zgjidhet pas 28

dhjetorit, “për t’i avancuar prioritetet e përbashkëta”. Shtetet e Bashkuara i kanë ndarë mbi 2 miliardë dollarë për Kosovën prej vitit 1998. Udhëheqës shtetërorë kosovarë e kanë përsëritur ndër vite që Amerika është partnerja më e rëndësishme e Kosovës dhe se mbështetja e saj është jetike.

Sa do të zgjasë “ndryshimi” i LV-së?

Donika Emini është skeptike, sidomos kur bëhet fjalë për qasjen ndaj medieve. Në sytë e saj, ndryshimi është imponuar nga rrethanat dhe nuk ka të bëjë me mënyrën se si LV-ja e kupton dhe respekton rolin e medias në demokraci. “Historikisht, LV-ja dhe Kurti kanë ndërtuar kapital politik mbi polarizimin dhe konfliktin. Prandaj, edhe pse është pozitive që po tentojnë të bëjnë paqe me mediet në këtë fazë, dyshoj fort se ky ndryshim është i qëndrueshëm dhe se do të reflektohet në një raport më të shëndetshëm me median kritike nëse ata qeverisin sërish”. I pyetur për t’i komentuar këto

vlerësime të Eminin dhe Muhaxhirit, zëdhënësi i Vetëvendosjes, Arlind Manxhuka i tha Radios Evropa e Lirë se partia është në fushatë zgjedhore dhe për çdo temë tjetër mund të deklarohet pas përfundimit të procesit zgjedhor. Pavarësisht zhvillimeve në të ardhmen, dëmi është bërë. Gjuha e përdorur nga LV-ja në drejtim të medieve është dënuar disa herë nga Bashkimi Evropian dhe organizatat ndërkombëtare të mediave. Liria e shtypit në Kosovë e ka pësuar më 2025 rënien më të madhe në 15 vjet, sipas Indeksit të Reporterëve pa Kufij. Për Muhaxhirin, gjithçka varet nga rezultatet zgjedhore. “Nëse LV-ja arrin rezultat shumë të mirë në zgjedhje, atëherë me siguri do t’i kthehet gjuhës së ashpër polarizuese. Në të kundërtën, nuk do të ketë shumë mundësi”. Në zgjedhjet e 28 dhjetorit të drejtë vote do të kenë mbi 2 milionë shtetas të Kosovës, brenda dhe jashtë vendit. Në këtë proces zgjedhor do të marrin pjesë 24 subjekte politike, me 1 180 kandidatë.

KQZ-ja akrediton mbi 18 mijë vëzhgues për zgjedhjet e 28 dhjetorit

PRISHTINË, 22 DHJETOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) në mbledhjen e mbajtur të hënën për akreditimin e grupit të katërt me 18 233 vëzhgues për vëzhgimin e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të cilat do të mbahen më 28 dhjetor. Besnik Buzhala, drejtor i

Zyrës për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike, ka paraqitur subjektet pulitke, organizatat ndërkombëtare, organizata joqeveritare, si dhe mediet vendore dhe të huaja, për të cilat tha se i kanë plotësuar kriteret ligjore. Anëtarët e KQZ-së votuan pro akreditimit të tyre, por për

vëzhguesit e Listës Serbe vota nuk patën dy anëtarët e KQZ nga LV-ja. Në mbledhjet e kaluara KQZ-ja ka akredituar edhe 852 vëzhgues të tjerë, të cilët përfaqësojnë: organizata joqeveritare vendore, organizata ndërkombëtare, media vendore/ ndërkomb-ëtare, institucione shtetërore dhe përfaqësi diplomatike.



BEDRI HAMZA: SI KRYEMINISTËR DO TË PUNOJ QË KOSOVA TË BËHET SHËTET I DIJES, ME EKONOMI DIGJITALE TË ZHVILLUAR



PRISHTINË, 22 DHJETOR - Kandidati i PDK-së për kryeministër, Bedri Hamza, ka vizituar ICK-në dhe theksoi rëndësinë e teknologjisë dhe inovacionit për ekonominë e Kosovës. Ai vuri në pah punën e të rinjve në fushat e Inteligjencës Artificiale, sigurisë kibernetike dhe printimit 3D, duke premtuar se si kryeministër do ta mbështesë

zhvillimin e një ekonomie digjitale dhe të dijes. “Një vizitë në ICK, sepse teknologjia dhe inovacioni po i japin kahje ekonomisë së re të Kosovës. Vajzat dhe djemtë e këtij sektori po krijojnë zgjidhje të reja në fushat e Inteligjencës Artificiale, sigurisë kibernetike dhe printimit 3D. Madje, edhe një pjesë e fushatës sime është duke

u gjeneruar me Inteligjencë Artificiale, si dëshmi e vizionit dhe përkushtimit tonë për inovacionin dhe të ardhmen. Si kryeministër, do të punoj që Kosova të bëhet një shtet i dijes, me ekonomi digjitale të zhvilluar dhe mbështetje të vazhdueshme për inovatorët tanë”, ka shkruar Hamza në “Facebook”.

UP-JA DHE INSTITUTI PËR MJEKËSI TROPIKALE ‘BERNHARD NOCHT’ FORCOJNË KAPACITETET PËR LUFTËN KUNDËR VIRUSEVE TË RREZIKSHME

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 22 DHJETOR - Ka më shumë se dhjetë vjet që Universiteti i Prishtinës është fitues i projekteve nga institucionet drejtuese të Gjermanisë me të cilat vazhdimisht luftohen viruset e rrezikshme me të cilët përballet Kosova. Që nga viti 2014 Universiteti i Prishtinës është përfitues i projekteve të financuara nga Qeveria e Gjermanisë në kuadër të Programit të Biosigurisë të Ministrisë Federale për Punë të Jashtme të Gjermanisë. Projektet janë zbatuar nga Instituti për Mjekësi Tropikale “Bernhard Nocht” në Hamburg dhe janë koordinuar nga dr. Petra Emmerich. Qëllimi kryesor i këtyre projekteve, në të cilat përveç UP-së janë të përfshirë edhe Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike dhe Klinika Infektive - Qendra

Klinike Universitare e Kosovës, ka qenë forcimi i kapaciteteve laboratorike në Kosovë për zbulimin e hershëm të viruseve me patogjenitet të lartë, si virusi i etheve hemorragjike Krime-Kongo, Hantavirusi, virusi i Nilit Perëndimor, Mpox-i etj. Në kuadër të bashkëpunimit janë realizuar hulumtime të përbashkëta shkencore, nga të cilat janë publikuar me dhjetëra punime në revista prestigjioze shkencore ndërkombëtare si dhe rezultatet e këtyre hulumtimeve janë paraqitur në konferenca ndërkombëtare, duke potencuar “Medical Biodefense Conference”, e cila mbahet çdo dy vjet në Munihi të Gjermanisë. Një komponent i rëndësishëm i projekteve ishte donacioni i pajisjeve laboratorike, materialit shpenzues, kiteve dhe reagjensëve të domosdoshëm për realizimin e hulumtimeve në Kosovë, gjithashtu edhe trajnimi i stafit në fushën e biosigurisë dhe realizimit të



teknikave laboratorike. Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë është një nga përfituesit e pajisjeve laboratorike bashkëkohore, kiteve dhe materialit shpenzues për monitorimin e viruseve te vektorët artropodë, ndërsa ato po shfrytëzohen edhe për

procesin mësimor dhe kërkimin shkencor. Profesori i këtij fakulteti dhe partneri i projektit gjerman në Kosovë, prof. Kurtsh Sherifi, për uebfaqen e Institutit për Mjekësi Tropikale “Bernhard Nocht” në Hamburg, tha se Programi Gjerman për Biosiguri

i Zyrës Federale për Punë të Jashtme të Gjermanisë ishte një nga projektet më efikase dhe më të rëndësishme në karrierën e tij shkencore deri më sot. “Projekti u karakterizua nga punë intensive dhe të përkushtuar, bashkëpunim të shkëlqyeshëm ndërpersonal dhe sukses të matshëm - rënie të rasteve të virusit të etheve hemorragjike Krime-Kongo (CCHFV) midis viteve 2013 dhe 2025”, tha profesori Sherifi, duke falënderuar shtetin gjerman në emër të Universitetit të Prishtinës dhe shtetit të Kosovës. Profesori Sherifi me dr. Matthew Montgomery janë udhëheqës shkencorë edhe në një projekt të përbashkët me komponentën mjekësore të ushtrisë amerikane dhe Mjekësisë Veterinare të UP-së për identifikimin e viruseve, baktereve dhe parazitëve të rrezikshëm për ushtarët dhe popullatën në zonën e kampit ushtarak amerikan “Bondsteel”.

Lehtësim për qytetarët dhe mërgatën, Agjencia e Regjistrimit Civil zgjat orarin e punës

PRISHTINË, 22 DHJETOR - Agjencia e Regjistrimit Civil (ARC), në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ka njoftuar se ka marrë vendim për zgjatjen e orarit të shërbimeve në të gjitha Qendrat për Pajisje me Dokumente për periudhën nga 23 dhjetori 2025 deri më 15

janar 2026. Sipas njoftimit, shërbimet do të ofrohen deri në orën 18:00, ndërsa edhe dita e shtunë, më 27 dhjetor 2025, do të jetë ditë pune me orar të zgjatur. Ky vendim është marrë me qëllim të lehtësimit të qasjes në shërbime për qytetarët dhe

bashkatdhetarët, duke pasur parasysh fluksin e shtuar gjatë festave të fundvitit dhe kthimit të bashkatdhetarëve në vendet e tyre. Agjencia ka bërë me dije se në koordinim me njësitë përkatëse në nivel lokal janë ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për

zbatimin e këtij vendimi, duke garantuar ofrimin e shërbimeve cilësore, me korrektësi dhe brenda afateve ligjore. ARC ka ritheksuar përkushtimin e saj për ofrimin e shërbimeve sa më të qasshme dhe efikase për të gjithë qytetarët.



Prishtina në mesin e qyteteve me ajrin më të ndotur në botë

PRISHTINË, 22 DHJETOR - Në bazë të renditjes së fundit të IQAir, kompani zvicerane që monitorin cilësinë e ajrit, katër kryeqytete të Ballkanit Perëndimor renditen mes qyteteve më të ndotura në botë. Prishtina ka zënë pozitën e 12-të të shtunën, kurse të dielën pozitën e 30. Sarajeva dje ishte renditur në pozitën e 13, kurse sot në

pozitën e 23-të. Beogradi dje ishte i 14-ti, kurse sot është i 31-ti. Shkupi dje ishte në pozitën e 14-t, ndërsa sot është në pozitën e 29, duke hyrë kështu në top 30 vendet më të ndotura në botë. Raportet e Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2025 tregojnë se shumica e vendeve të rajonit nuk kanë bërë kurrfarë përpqarimi në përmirësimin e cilësisë së ajrit

që nga viti 2024, ndotja e të cilit vazhdon të paraqesë rrezik të madh për shëndetin publik. Ndryshe, qytetet më të ndotura në botë sipas cilësisë së ajrit që renditen në krye të listës janë Lahore në Pakistan, Delhi dhe Kolkata në Indi, Dhaka në Bangladesh, Kajro në Egjipt, Doha në Katar, Bagdadi në Irak, Hanoi në Vietnam dhe Katmandu në Nepal.



FLET VËLLAI I LIRIDONA ADEMAJT PASI U SHFAQEN PAMJET E NATËS KRITIKE: U DËSHMUA QË VRASJA ISHTE E ORGANIZUAR

PRISHTINË, 22 DHJETOR - Vëllai i Liridona Ademajt, Leonard, ka deklaruar të hënën se pamjet e paraqitura në seancën e fundit gjyqësore ndaj Naim Murselit, Granit Plavës dhe Kushtrim Kokallës dëshmojnë se vrasja e motrës së tij ka qenë e planifikuar dhe e organizuar nga të tre të akuzuarit. Pas përfundimit të seancës, Leonard Ademaj, në një prononcim për medie, ka theksuar se familja mbetet e shqetësuar për moslejimin e elaborimit të plotë të provave dhe paralajmëroi se do të kërkojnë sërish nga gjykata që provat të trajtohen në mënyrë më të hollësishme pasi, sipas tij, ato janë jetike për zbardhjen e rolit të secilit të akuzuar në këtë



rast.

Ademaj ka thënë se seanca nuk ka qenë e lehtë për familjen, pasi janë shfaqur pamjet e fundit të jetës së motrës së tij,

duke theksuar se nga ajo që u pa në video rezulton se e gjithë ngjarja ka ndodhur brenda një kohe shumë të shkurtër. Sipas tij, kjo dëshmon se nuk bëhet

fjalë për një vrasje të rastësishme, por për një akt të planifikuar. “Sot për ne nuk ishte një ditë e lehtë pasi që i pamë edhe videot e fundit të jetës së motrës sonë. Ajo se çfarë pamë në video sot ishte që tre të akuzuarit e kanë planifikuar vrasjen, pasi që e gjithë ngjarja ka ndodhur vetëm për 7 minuta. Pra nuk ishte një vrasje e paplanifikuar, por ishte e planifikuar mirë nga tre të akuzuarit. Ajo çfarë pamë sot në këto pamje qartëson mirë se Naimi së bashku me Kushtrimin janë organizatorët e vrasjes, ndërsa vrasës i motrës sonë është Granit Plava”, është shprehur ai. Ademaj ka shtuar se një nga shqetësimet kryesore të familjes

mbetet moslejimi i elaborimit të provave nga ana e tyre, duke vlerësuar se kjo është thelbësore për zbardhjen e plotë të rastit. “Ajo se çfarë na brengosi sot ishte moslejimi i elaborimit të provave nga ana jonë. Pra ky elaborim i provave për ne është jetësor sepse e qartëson edhe më mirë rolin kyç të Kushtrim Kokallës, bashkëpunimin së bashku me Naimin dhe rrugëtimin e tyre. Pra ne do të kërkojmë përsëri nga gjykata që t'i elabrojmë provat sepse është e drejtë jetike. Mendoj që me ato prova të cilat i kemi dhe që mendojmë se duhet të dalin, qartësohet edhe më mirë grupi i tyre i organizuar në mënyrë profesionale për vrasjen e motrës sonë”, ka thënë Ademaj.

SHËNJESTROHET RASTI “QIELLI I THYER”, ARRIN NË RRETH 80 MILIONË EURO VLERA E PASURISË SË SEKUESTRUAR



PRISHTINË, 22 DHJETOR - Nën udhëheqjen e Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale, Blerim Isufaj, është mbajtur takimi i radhës me Ekipin e Përbashkët për Përzgjedhjen dhe Shenjëstrimin e Krimeve të Rënda. Gjatë këtij takimi është shenjëstruar rasti i koduar “Qielli i thyer” për veprat penale: Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal lidhur me veprat: blerja, posedim, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e

narkotikëve, substancë psikotrope dhe analoge; Shpëlarja e parave; Falsifikim i parasë; Falsifikim i dokumenteve; dhe mbajtja në pronësi ose posedim të pauatoizuar të armëve. 33 persona ndodhen në paraburgim, ndërsa janë ndaluar me urdhër pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme në vlerë rreth 60 milionë euro. Po ashtu, janë ngrirë mjete financiare në llogari bankare në vlerë rreth 1.5 milion euro

dhe janë sekuestruar 80 vetura luksoze me vlera milionëshe, duke bërë që vlera totale e pasurisë së sekuestruar deri më tani të arrijë rreth 80 milionë euro. Hetimet janë zgjeruar dhe, për shkak të ndjeshmërisë së rastit, janë caktuar dy prokurorë për trajtimin e tij. Prokuroria Speciale mbetet e përkushtuar që ta trajtojë këtë rast me prioritet, duke ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për zbardhjen e plotë të rastit.

Operacion policor në Pejë, arrestohet R. H.

PEJË, 22 DHJETOR - Operacioni policor në Pejë ka përfunduar të hënën dhe është arrestuar i pandehuri R. H., siç edhe ishte planifikuar, në bazë të urdhrat të kontrollit, nën dyshimin për kryerjen e veprave penale: “Krim i organizuar lidhur me veprën penale ‘Rrëmbimi’; “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të

paaautorizuar të armëve”. “Aksioni i sotëm, në të cilin kanë marrë pjesë njësitë relevante të Policisë së Kosovës, është rezultat i një procesi hetimor mbi dyshimet për rrëmbimin e një personi, rast i cili kishte ndodhur në vitin 2021. Lidhur me këtë rast, një tjetër i dyshuar ndodhet në paraburgim. Gjatë

zbatimit të urdhrat të kontrollit janë siguruar prova relevante që do të shërbejnë gjatë procedurës hetimore. Brenda afatit ligjor, Prokuroria Speciale do të të parashtrorë kërkesë për caktimin e masës së sigurisë ndaj të arrestuarit R. H.”, ka njoftuar Prokuroria Speciale e Kosovës.



DhTIK, anëtare Kandidate e Zgjerimit në Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian

PRISHTINË, 22 DHJETOR - Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Kosovë ka bërë me dije se është përzgjedhur Anëtare Kandidate e Zgjerimit (Enlargement Candidate Member - ECM) në Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian (EESC).

Në njoftim thuhet se me këtë hap, Dhoma, si përfaqësuese e qindra bizneseve në Kosovë, do të kontribuojë në hartimin e opinioneve të EESC-së që lidhen me organizatat e shoqërisë civile dhe procesin e zgjerimit të Bashkimit Evropian. “Përzgjedhja nga

EESC, përfaqëson një njohje të rëndësishme ndërkombëtare për rolin e Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Kosovë në përfaqësimin e interesave të komunitetit të biznesit, si dhe një mundësi e drejtpërdrejtë për të kontribuar në proceset konsultative dhe politike të

Bashkimit Evropian. DhTIK mbetet e përkushtuar që, përmes këtij angazhimi, të avancojë zërin e sektorit privat të Kosovës dhe të kontribuojë në procesin e integritimit evropian të vendit”, thuhet në komunikatën për medie.



KONSUMI I RRYMËS TEJKALON REKORDET E MËPARSHME, BËHET THIRRJE PËR KURSIM

PRISHTINË, 22 DHJETOR - Operator i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) ka bërë me dije se konsumi i energjisë elektrike është tejkaluar dhe rekordet e mëparshme të ngarkesës janë regjistruar në sistem. KOSTT ka thënë se sistemi energjetik vazhdon të përballët me ngarkesë të rritur, veçanërisht gjatë orëve të pikut. “Konsumi më i lartë vërehet kryesisht në intervalet kohore 09:00-12:00, 16:00-20:00 dhe 22:00-23:00 ndaj ftojmë të gjithë konsumatorët që kur të jetë e mundur, të zhvendosin përdorimin e pajisjeve me konsum të lartë të energjisë në



orë jashtë pikut, veçanërisht pas mesnatës, kur konsumi është dukshëm më i ulët”, thuhet në njoftim.

KOSTT u ka bërë thirrje qytetarëve, institucioneve publike dhe bizneseve që ta përdorin energjinë me kujdes

dhe të kontribuojnë që furnizimi të mbetet sa më i qëndrueshëm për të gjithë. “Për të mbrojtur pajisjet e sistemit dhe për të shmangur mbingarkesat, janë kërkuar këto kufizime të ngarkesës: NS Rahoveci (përfshi zonën e Malishevës): rreth 12 MW, NS Prizreni 1 (përfshi zonën e Dragashit): rreth 10 MW”. Rritja më e madhe e çmimit të energjisë elektrike në Kosovë është regjistruar gjatë dy viteve të fundit, duke rënduar më tej faturat e konsumatorëve dhe duke ngritur shqetësime mbi përballueshmërinë e kostove energjetike për qytetarët dhe

bizneset. Megjithatë, qytetarët vazhdojnë të përballen me mungesë të energjisë elektrike. Gjatë vitit 2024 shumë komuna të Kosovës u përballën me reduktime të energjisë elektrike. Për shkak të vjetërsisë disadekadëshe të termocentraleve “Kosova A” dhe “Kosova B”, Kosova nuk mund ta sigurojë energjinë e nevojshme për mbi 1.6 milion banorët e saj. Prodhim ka edhe nga burimet e ripërtëritshme, por në sasi më të vogla. Prodhimi i pamjaftueshëm bën që një pjesë e konsiderueshme e furnizimit të sigurohet përmes importeve të cilat janë të shtrenjta.

NGA PRISHTINA NË GJITHË KOSOVËN, KU PO RRIKET MË SË SHUMTI NDËRTIMI?



PRISHTINË, 22 DHJETOR - Ndërtimi në Kosovë nuk është më i përqendruar vetëm në kryeqytet, por po shtrihet me intensitet të lartë edhe në komunat dhe regionet e tjera të vendit, ku po zhvillohen projekte të reja banesore dhe urbane dhe jo vetëm. Kështu u tha në “Përballje Podcast” nga Faton Hoxha, i cili theksoi se “boom” ndërtimi po vërehet në të gjitha regionet e

Kosovës. “Në secilin prej regjioneve të Kosovës ka boom ndërtimi - Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Gjilan dhe Ferizaj”, u shpreh Hoxha. Sipas tij, Ferizaj është ndër komunat me zhvillimin më të shpejtë ekonomik dhe ndërtimor pas Prishtinës, ndërsa Prizreni po shënon zgjerim të madh drejt zonave përreth. “Prizreni praktikisht po bashkohet me zonat përreth përmes projekteve

të mëdha ndërtimore”, tha Hoxha shkruan “Telegrafi”. Ai theksoi se edhe Gjakova po përjeton rritje të ndjeshme të ndërtimeve të reja pavarësisht prej madhësisë së qytetit, ndërsa zhvillim të vazhdueshëm po shënojnë edhe Peja, Gjilani dhe Mitrovica. Hoxha shtoi se dhënia e lejeve të reja ndërtimore dhe vazhdimi i projekteve të mëdha tregojnë qartë se kërkesa për banesa

ekziston edhe jashtë kryeqytetit. “Përdërisa po jepen leje të reja ndërtimi, kjo tregon se ka kërkesë. Në momentin që nuk ka kërkesë, nuk ka as ndërtim”, theksoi ai. Në përmbyllje, Hoxha tha se ndërtimi do të vazhdojë në të gjitha këto komuna për aq kohë sa ekziston interes real për blerje. “Derisa ka blerës dhe kërkesë reale, ndërtimi nuk do të ndalet”, përfundoi ai.

HYSENI DHE DURMISHI DISKUTOJNË PËR REALIZIMIN E PROJEKTEVE INFRASTRUKTURE NË GJILAN

GJILAN, 22 DHJETOR - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, ka pritur në takim ministrin në detyrë të Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Hysen Durmishin, me të cilin ka diskutuar për projektet e realizuara dhe ato që janë në proces në këtë komunë. Pas takimit, Hyseni dhe Durmishi kanë vizituar disa nga projektet

infrastrukturore në terren, përfshirë rrugën “Hamdi Kurteshi”, ku po realizohet një investim në vlerë prej 2.4 milionë eurosh si dhe segmentet e autoudhës Bresalc - Banullë, pjesë e autostradës Prishtinë - Gjilan. Kryetari Hyseni e ka falënderuar ministrin për vizitën dhe mbështetjen e vazhdueshme të ministrisë, duke theksuar se në vitet e fundit janë realizuar

dhjetëra projekte në dobi të qytetarëve të Gjilanit. Ai ka shprehur shpresën se kjo mbështetje do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Ndërsa ministri në detyrë i Infrastrukturës, Hysen Durmishi, tha se vizita në Gjilan kishte për qëllim vlerësimin e projekteve në terren dhe urimin e kryetarit Hyseni për mandatin e tij të dytë. Ai theksoi se gjatë mandatit të



kaluar janë ndërtuar dhe rehabilituar dhjetëra rrugë në këtë komunë, duke përmirësuar ndjeshëm qarkullimin dhe infrastrukturën. Durmishi bëri me dije se punimet në rrugën “Hamdi Kurteshi” po zhvillohen me intensitet të lartë, ndërsa sa i përket autostradës Prishtinë - Gjilan ai konfirmoi se janë shkëputur katër kontrata për katër segmentet.

Murati: ATK-ja për herë të parë arrin shifrën prej një miliard eurosh tatime të mbledhura brenda vitit

PRISHTINË, 22 DHJETOR - Ministri në detyrë i Financave, Hekuran Murati, ka bërë me dije se Administrata Tatimore e Kosovës për herë të parë ka arritur ta tejkalojë shifrën prej një miliard eurosh tatime të

mbledhura brenda vitit, duke shënuar kështu rekord historik. “Ky rekord është arritur ende pa përfunduar viti fiskal, me datën 16 dhjetor. Kjo arritje përbën më shumë se dyfishim të mbledhjes së

tatimeve brenda vendit, nga 467 milionë euro sa ishte në mbi 1 miliardë euro, për vetëm 5 vite. Gjatë së njëjtës periudhë: Qarkullimi i bizneseve është rritur nga 12 miliardë euro në 25 miliardë

euro. Fitimi i korporatave është rritur nga 900 milionë euro në 2.3 miliardë euro. Numri i vendeve të punës është rritur nga 350 mijë në 435 mijë”, ka shkruar në “Facebook” Murati.



SI E MORI VETEN RUSIA

Çfarë po mëson Kremlini nga lufta në Ukrainë



Dara MASSICOT

Historia e pushtimit rus të Ukrainës ka qenë një histori pritshmërisht të përmbytura dhe luhatjesh të forta në performancë. Në fillim të luftës, shumica e NATO-s e shihte Rusinë si një kolos të pandalshëm, gati për ta mposhtur shpejt Ukrainën. Në vend të kësaj, forcat ruse u ndalën dhe u zmbrapsën. Më pas, vëzhguesit e jashtëm arritën në përfundimin se ushtria ruse ishte e kalbur, ndoshta një kundërofensivë larg kolapsit. Edhe kjo doli e pasaktë: ofensivat ukrainase dështuan dhe Moska rifilloi përparimin e saj të ngadalhtë. Tani, shumëkush po e kërkon shpjegimin diku tjetër, duke ia atribuar vështirësitë e Kievit mbështetjes së pamjaftueshme nga jashtë. Ajo që shumë politikëbërës dhe strategë nuk e kanë kuptuar është shkalla në të cilën Moska ka nxjerrë mësim nga dështimet e saj dhe ka përshtatur strategjinë dhe mënyrën e saj të luftimit, si në Ukrainë ashtu edhe përtej saj. Duke filluar nga viti 2022, Rusia nisi një përpjekje sistematike për të analizuar përvojën e saj luftarake, për të nxjerrë mësim prej saj dhe për t'i shpërndarë këto mësim në të gjithë forcat e armatosura. Që në fillim të vitit 2023, Moska kishte ndërtuar në heshtje një

ekosistem kompleks të të mësuarit, që përfshin bazën e prodhimit të mbrojtjes, universitetet dhe ushtarët në të gjitha nivelet e zinxhirit komandues. Sot, ushtria po institucionalizon dijen e fituar, po riorienton prodhuesit e mbrojtjes dhe organizatat kërkimore për t'iu përgjigjur nevojave të luftës, dhe po lidh startup-e teknologjike me burimet shtetërore. Rezultati ka qenë shfaqja e taktikave të reja në fushëbetejë, të kodifikuara në programe stërvitjeje dhe manuale luftarake, si edhe armë më të mira. Moska ka zhvilluar mënyra të reja për përdorimin e dronëve për të zbuluar dhe vrarë ushtarë ukrainas dhe për të shkatërruar asetet e Ukrainës, duke e kthyer një dobësi të mëparshme në një pikë force. Ajo ka ndërtuar raketa më të mira dhe ka krijuar sisteme të blinduara më të forta dhe më të afta. Po u jep komandantëve të rinj më shumë liri për të planifikuar. Është shndërruar në një ushtri që është e aftë të evoluojë gjatë kësaj lufte dhe, njëkohësisht, të përgatitet për konflikte të ardhshme të teknologjisë së lartë. Për shkak të këtyre ndryshimeve, Ukraina ka gjasë të përballë me shkatërrim edhe më të madh në muajt që vijnë. Do të duhet të përballojë sulme ruse me dronë më të shpejta dhe më të shumta, duke sjellë më shumë dëme për


qytetet, civilët dhe infrastrukturën kritike. Një numër më i madh raketash do të depërtojë përmes mbrojtjes së Ukrainës. Dhjetë kilometrat që çojnë drejt vijave të frontit, tashmë tepër të rrezikshme, do të bëhen edhe më të vështira dhe më të rrezikshme për t'u kaluar. Këto ndryshime mund të mos prodhojnë ndonjë përparim dramatik për Rusinë, falë mbrojtjes së Ukrainës dhe sulmeve të saj intensive me dronë dhe artileri. Por ato nënkuptojnë se Moska mund të vazhdojë të shkëmbejë jetët e ushtarëve të saj për fitime të ngadalta në Donbas, duke shpresuar se NATO do të lodhet nga konflikti. Disa zyrtarë amerikanë dhe evropianë, në fakt, po humbasin interesin për Ukrainën. Por të njëjtat përshtatje ruse që e kërcënojnë Ukrainën duhet të shqetësojnë edhe politikëbërësit gjatë. Ushtria ruse do të dalë nga pushtimi me një përvojë të gjerë dhe me një vizion të qartë për të ardhmen e luftës, dhe këtë përvojë po e ndan me Kinën, Iranin dhe Korenë e Veriut. Ajo ka hedhur themelet për një periudhë edhe më intensive të të mësuarit dhe riorganizimit pas përfundimit të luftës. Rusia do të mbetet e kufizuar nga disiplina e dobët dhe do të ketë vështirësi në prodhimin e pajisjeve më të sofistikuar. Por, pavarësisht kufizimeve në

burime, ajo do të jetë po aq e përgatitur për mënyrën e re të luftës, sa çdo shtet tjetër. Nëse nuk duan të mbeten prapa, Uashingtoni dhe kryeqytetet evropiane duhet të fillojnë të mësojnë nga lufta në Ukrainë, jo t'i kthejnë shpinën asaj. Në vend që ta nënvlerësojnë, ata duhet të studiojnë se si po studion Rusia, dhe më pas të nisin ndryshimet e tyre.

KOMPLEKSI INDUSTRIAL QË MËSON

Që në ditët e para të pushtimit, ushtria ruse është detyruar të përshtatet me rrethanat në terren. Për t'i mbijetuar kundërsulmeve të ashpra ukrainase, njësitë ruse u pajisën mjetet me mbrojtje shtesë të improvizuar, mësuuan forma të reja kamuflimi dhe adoptuan taktika sulmi me njësi të vogla, mes shumë përshtatjesh të tjera. Ushtarët rusë ndanë gjithashtu këshilla në mënyrë informale përmes rrjeteve sociale, kanaleve të mbyllura në media sociale dhe manualeve këshilluese të vetëbotuara. Ky lloj mësimi informal, nga individit te individit ose nga njësi në njësi, është një fazë e rëndësishme fillestare e përshtatjes në kohë lufte. Por nëse organizata ushtarake në tërësi nuk i përvetëson këto mësim, ato shpesh humbasin me kalimin e kohës, nuk u

kalohen atyre që kanë nevojë për to dhe nuk përhapen në të gjithë forcën. Faza e dytë e të mësuarit përfshin institucionalizimin e këtyre ndryshimeve, për shembull përmes rishikimit të programeve të stërvitjes, planeve të prokurimit dhe koncepteve operacionale. Më pas, ushtritë duhet të angazhohen në një mësim parashikues mbi të ardhmen e luftës dhe të pranojnë nevojën për reforma ose ndryshime transformuese. Ushtritë që mësojnë më mirë ndjekin pesë hapa: përvetësojnë përvojën luftarake, e analizojnë atë, propozojnë rekomandime, i shpërndajnë rekomandimet dhe mësimet në të gjithë forcën dhe, së fundi, i zbatojnë ato. Sapo u bë e qartë se lufta do të zgjatej, Rusia filloi të përmbushte shumicën e këtyre kritereve. Ajo që nisi si një përshtatje ad hoc në fushëbetejë u shndërrua në një përpjekje sistematike për të marrë përvojën e fituar në luftë, për ta studiuar atë dhe për ta shpërndarë në të gjithë ushtrinë, me qëllim përmirësimin e performancës. Në vitin 2022, për shembull, ushtria dërgoi oficerë të posaçëm stafi dhe studiues në pikat komanduese pranë vijës së frontit, në mënyrë që ata të vëzhgonin luftën sa më nga afër dhe të kuptonin më mirë performancën e trupave. Më pas, studiuesit shqyrtuan rezultatet e betejave, analizuan



ARB MANAJ, “FUTBOLLIST I VITIT 2025”, AMIR RRAHMANI, FITUES I ÇMIMIT “FADIL VOKRRI”

PRISHTINË, 22 DHJETOR - Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) ka organizuar mbrëmjen madhështore “Laureatët 2025”, një event tradicional përmes të cilit janë nderuar dhe vlerësuar individët, klubet dhe institucionet që kanë kontribuar në zhvillimin dhe avancimin e futbollit të Kosovës gjatë vitit 2025. Kjo ceremoni prestigjioze edhe sivjet mbledhi figurat më të rëndësishme të futbollit vendor dhe mysafirë të shumtë, përfshirë presidentin e Federatës Shqiptare të Futbollit (FShF), njëherësh zëvendëspresidentin e UEFA-s, Armand Duka, si dhe ministrin në detyrë të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku.

Çmimi më i rëndësishëm i mbrëmjes, “Futbollisti i Vitit 2025” në futbollin e Kosovës, i ka takuar sulmuesit të FC Drita, Arb Manaj, të cilit trofeun ia ka dorëzuar presidenti i FFK-së, Agim Ademi, presidenti i FShF-së, Armand Duka dhe ministri Hajrulla Çeku. Manaj është vlerësuar si më i miri nga votat e gazetarëve sportivë. Ai ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm gjatë gjithë vitit në radhët e skuadrës gjilanasë, duke qenë ndër lojtarët më meritorë në rikthimin e titullit kampion në Gjilan, si dhe në suksesin historik të Dritës me kualifikimin në “play-off” për 1/8 e finales në UEFA Conference League.

Ndërkohë, çmimi “Fadil Vokrri”, që nderon trashëgiminë e një prej figurave më të mëdha të futbollit të Kosovës, i është ndarë Amir Rrahmanit, kapitenit të Kombëtares së Kosovës dhe lojtarit të Napolit në Serinë A. Rrahmani edhe këtë vit ishte në nivelet më të larta, duke fituar sërish titullin kampion në Itali me Napolin dhe duke qenë lider i padiskutueshëm

i Kombëtares. Për shkak të angazhimeve në finalen e Superkupës së Italisë në Riad, ai nuk kishte mundësi të ishte i pranishëm në ceremoni, ndërsa çmimi do t'i dorëzohet personalisht më vonë.

Gjatë fjalimit të tij, presidenti i FFK-së, Agim Ademi, ka folur për arritjet historike të futbollit të Kosovës në vitin 2025, duke theksuar rolin e gjeneratave që kanë mbajtur gjallë futbollin ndër vite. Ai ka vlerësuar figurat historike, gjeneratën e artë, si dhe përzgjedhësin Franco Foda, duke shtuar se roli kryesor në ngritjen e futbollit u takon klubeve dhe futbollistëve, që janë baza e federatës.

I pari i futbollit të Kosovës ka theksuar se investimet në infrastrukturë po vazhdojnë me intensitet të lartë. Në fund, Ademi ka thënë se Kombëtarja e Kosovës është vetëm dy hapa larg realizimit të ëndrrës për kualifikimin në Kampionatin Botëror dhe se do të bëhet çmos për t'u arritur kualifikimi në Kupën e Botës.

Ndërsa ministri në detyrë i MKRS-së, Hajrulla Çeku, e ka cilësuar vitin 2025 pozitiv për futbollin e Kosovës, duke theksuar se Kombëtarja ka dëshmuar se është konkurrese në Evropë. Edhe presidenti i FShF-së dhe zëvendëspresidenti i UEFA-s, Armand Duka, ka vlerësuar lart zhvillimet në futbollin e Kosovës në vitet e fundit. Ai ka përgëzuar rezultatet e Kombëtares së Kosovës nën drejtimin e Franco Fodës dhe ka premtuar mbështetje të vazhdueshme për futbollin e Kosovës.

Po ashtu, të pranishmëve u është drejtuar përmes një videomesazhi presidenti i FIFA-s, Gianni Infantino, ndërsa presidenti i UEFA-s, Aleksander Ceferin, ka



dërguar një letër përshëndetëse, në të cilën ka përgëzuar FFK-në për punën, progresin e qëndrueshëm dhe përkushtimin në zhvillimin e futbollit në Kosovë, duke uruar suksese të mëtejme në vitin 2026 dhe fat në ndeshjet e “play-off”-it drejt Kupës së Botës. Përveç dy çmimeve kryesore janë vlerësuar edhe shumë individë dhe klube që kanë treguar suksese në vitin 2025. Sulmuesi i FC Ballkani, Valentin Serebe, është shpallur golashënuesi i vitit 2025. Me sukseset, strategjitë, udhëheqësinë dhe motivimin e tij, Zekirija Ramadani është shpallur “Trajneri i Vitit 2025”, pasi e ka udhëhequr FC Dritën drejt titullit kampion dhe drejt një paraqitjeje historike në UEFA Conference League. Për sukseset e arritura, FC Drita është shpallur “Klubi më i Mirë i Vitit” në konkurrencën e meshkujve, ndërsa ka fituar edhe çmimin “Fair Play”.

Drita ka dominuar edhe në përzgjedhjen e 11-shes më të mirë të vitit 2025, e cila është formuar në bazë të votave të trajnerëve të AlbiMall Superligës. Formacioni ideal i vitit 2025 është në shpallur në këtë përbërje: Faton Maloku (FC Drita), Besnik Krasniqi (FC

Drita), Arlind Veliu (FC Malisheva), Egzon Bejtulahi (FC Drita), Bajram Jashanica (FC Ballkani), Albert Dabiqaj (FC Drita), Etnik Brruti (FC Malisheva), Walid Hamidi (FC Ballkani), Arianit Hasani (FC Llapi), Sunday Adetunji (FC Ballkani) dhe Arb Manaj (FC Drita). Në konkurrencën e vajzave, çmimi “Futbollistja më e Mirë e Vitit” i ka takuar Aurora Muliqit nga KFF Mitrovica, ndërsa “Shpresa e Vitit 2025” është shpallur Anisa Mehanga KFF 2 Korriku U17.

Epiteti i “Klubit më të Mirë” në futbollin e vajzave i takoi KFF Mitrovica, kampione e Kosovës dhe përfaqësuese në garat evropiane. Në futsall, dominimi ishte i FC Prishtina 01, e cila është shpallur “Klubi më i Mirë i Vitit”, për sukseset në garat vendore dhe paraqitjen deri në 1/8 e finales të UEFA Futsal Champions League. Ndërkohë, Fitim Krasniqi anëtar i këtij klubi është shpallur “Lojtari i Vitit 2025” në futsall. Çmimi për “Referin më të Mirë të Vitit” i është ndarë Alban Shalës. Në këtë event janë nderuar edhe personalitete me kontribut të veçantë ndër vite. Çmimi për “Kontribut të Çmuar

Ndër Vite” i është ndarë Rexhep Bahollit (FC 2 Korriku), Nexhmendin Haxhiut (FC Trepça) dhe Abedin Zekës (FC Trepça '89). Me mirënjohje janë nderuar gjithashtu Gafurr Kabashi, Muharrem Muslija dhe Sabri Hashani për kontributin e tyre historik në futbollin e Kosovës. Çmimi për “Arritje Ndërkombëtare” i ka takuar Florentina Kallabës, e cila ishte gjyqtare në finalen e Kupës së Botës në futsall që është mbajtur në Filipine. Me mirënjohje të veçantë është nderuar edhe tifogrupi “Dardanët”, për mbështetjen e palëkundur ndaj Kombëtares së Kosovës. Po ashtu, FFK-ja ka ndarë mirënjohje për partnerët e saj institucionale dhe komerciale: MKRS-ja, Policia e Kosovës, komuna e Prishtinës, Aeroporti Ndërkombëtar “Adem Jashari”, si dhe sponsorët dhe partnerët “TEB”, “Albi Mall”, “Raiffeisen Bank”, “Siguria”, “BPB”, “Emerald”, “Mokne”, “Art Motion”, “Vatan”, “Link Plus” dhe “Erreà”. Ndërkaq, edhe këtë vit FFK-ja ka ndarë mirënjohje “post mortem” për personalitetet e futbollit që gjatë këtij viti janë ndarë fizikisht nga ne.

2025-A, VIT HISTORIK PËR FUTBOLLIN E KOSOVËS

PRISHTINË, 22 DHJETOR - Viti 2025 ishte pa dyshim më i suksesshmi për futbollin e Kosovës që nga anëtarësimi në UEFA dhe FIFA. Vetëm nëntë vjet pas bashkimit në familjen evropiane dhe botërore të futbollit, vendi ynë jo vetëm që po mban hapin, por po korr rezultate që shpesh i lakmojnë edhe federata me dekada të tëra traditë ndërkombëtare. Ky vit dëshmoi fuqinë e futbollit të Kosovës si përmes suksesit të Kombëtares së Kosovës, po ashtu edhe përmes arritjeve historike të FC Drita në Ligën e Konferencës dhe FC Prishtina 01 në Ligën e Kampionëve të Futsallit. Puna e palodhshme e kreut të Federatës, Agim Ademi, dhe vizioni i përzgjedhësit Franco Foda në afrimin e lojtarëve



cilësorë e të rinj, sollën rezultate të prekshme. Në mars, Dardanët shkruan faqen e parë të këtij viti të artë: Kosova u ngjiti në Ligën B të Ligës së Kombeve pas dy fitoreve të merituar ndaj Islandës, 2:1 në “Fadil Vokrri” dhe 3:1 në Murcia të Spanjës. Një kapitull i ri u hap për

futbollin tonë, por rrugëtimi nuk u ndal këtu. Në kualifikimet për Botërorin 2026, Kosova arriti një tjetër moment historik: përfundoi e dyta në Grupin B me 11 pikë, duke siguruar për herë të parë “play-off”-in e Kupës së Botës. Humbja ndaj Zvicrës në Bazel vetëm sa e forcoi kampin e

Dardanëve. Dy fitore të mëdha ndaj Suedisë, një fitore dhe një barazim ndaj Sllovenisë dhe një barazim ndaj Zvicrës mbyllën një cikël madhështor. Tani para nesh qëndrojnë dy sfida vendimtare: në mars gjysmëfinalja me Sllovakinë në Bratislavë dhe, në rast fitoreje, finalja e madhe në “Fadil Vokrri” ndaj Turqisë ose Rumanisë. Realizimi i këtij objekti do ta dërgonte Kosovën në Grupin D të Botërorit 2026, së bashku me ShBA-në, Paraguain dhe Australinë - një ëndërr e shumë gjeneratave. Seria brilante prej 8 fitoreve, 2 barazimeve dhe vetëm 1 humbjeje gjatë vitit 2025 e ngriti dukshëm Kosovën edhe në renditjen botërore. Dardanët po e mbyllin vitin në vendin e 80 të FIFA-s. Viti ishte i suksesshëm

edhe për Kombëtarën U21, e cila nisi rrugëtimin drejt Euro 2027 me bilanc pozitiv: 2 fitore, 2 barazime dhe vetëm një humbje. Ndërkaq, Kombëtarja U17 e vajzave siguroi kalimin e merituar në Ligën A për kualifikimet e Euro 2026. Në arenën e klubeve, suksesi ishte po aq mbresëlënës: FC Drita u bë klubi i parë nga Kosova që arriti ta kalojë fazën e ligës së Conference League, duke siguruar play-off-in për 1/8 e finales dhe duke na bërë krenarë me paraqitjet e saj. Ndërsa FC Prishtina 01 shkroi histori në futsall, duke arritur deri në 1/16 e finales së Championsit. Të gjitha këto suksese nuk janë rastësi. Ato janë fryt i punës, angazhimit dhe vizionit të qartë me të cilin po ecën futbollit i Kosovës.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

